



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.06.2018 ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 18 qershor – 6 korrik 2018.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Nënkryetare e Kuvendit
Senida Mesi –	Zëvendëskryeministre
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Eduard Shalsi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Erion Braçe -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Edi Paloka -	Nënkryetar i Kuvendit
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike
Petrit Vasili -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim / Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Fatmir Mediu -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Albana Vokshi -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Genc Pollo -	Kryetar i Komisionit për Integrimin Europian

Marrin pjesë:

Mimoza Pano - Drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Kam thirrur Konferencën e Kryetarëve për miratimin e kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 18 qershor- 6 korrik 2018. Si zakonisht, në përfundim të periudhës 3-javore, ka ardhur koha të miratojmë kalendarin e ri. Javën e ardhshme, siç e shikoni, sugjerohet të mos zhvillohet seancë plenare, për arsye që t’u lëmë kohë komisioneve, pasi nuk kanë ligje gati, por, nëse nuk gabohem, është edhe festë.

Jeni njohur me draftkalendarin. Seancat janë parashikuar në datat 21 qershor, 28 qershor dhe më 5 korrik në orën 10:00. A ka sugjerime për draftkalendarin?

Po, urdhëroni, zonja Felaj!

Ermonela Felaj – Sugjeroj që projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”” t’i kalojë për mendim edhe Komisionit të Sigurisë.

Gramoz Ruçi – Zoti Braçe, urdhëroni!

Erion Braçe- Shikoj se është rikthyer procedura për propozimin e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik dhe shoh se komision përgjegjës është ngarkuar Komisioni për Ekonominë dhe Financat dhe komision për dhënie mendimi është ngarkuar Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike. Kjo është e re, nuk ka ndodhur ndonjëherë, për më tepër që ligji për prokurimet publike ngarkon Komisionin e Ekonomisë për këtë gjë. Nuk e kuptoj se çfarë do të vlerësojë Komisioni i Ligjeve, do të bëjë seancë dëgjimore më vete?

Gramoz Ruçi – Si qëndron puna, mund të na shpjegoni Moza?

Mimoza Pano – Kryetar, Komisioni i Ligjeve është përfshirë për dhënie mendimi, për shkak se Komisioni i Prokurimit Publik është një strukturë kuazi gjyqësore, e cila shqyrton ankimet e procedurave të prokurimit dhe ndoshta mund të vlerësojë anën juridike të çështjes.

Erion Braçe – Cilës çështje?

Së pari, që Komisioni i Prokurimit Publik është një strukturë kuazi gjyqësore, ky është opinion. Ligji e ngarkon Komisionin e Prokurimit Publik me detyra të posaçme, nuk i ka dhënë as detyrën e gjykatës dhe as detyrën e gjykatësit asnjërit prej atyre njerëzve atje. Kështu që ky është opinion.

Së dyti, ligji ngarkon Komisionin e Ekonomisë, madje është shprehur specifikisht që i jep të drejtën të bëjë edhe seanca dëgjimore me ta. Për çfarë duhet komisioni tjetër, në tejkalim të ligjit për prokurimin publik?

Ulsi Manja – Unë nuk shoh asgjë të keqe këtu, sepse ne jemi komision për dhënie mendimi dhe kemi Nënkomisionin për Administratën Publike.

Erion Braçe – S’ka asnjë lloj lidhjeje. T’i lëmë këto histori, se nuk ka asnjë lloj lidhjeje.

Ulsi Manja – Komisioni për Ekonominë është komision përgjegjës dhe, sigurisht, raportin përfundimtar për seancën e përpilon Komisioni për Ekonominë. Nuk mendoj se...

(Reagim pa mikrofon)

Dakord! Nuk mendoj se e cenon Komisionin e Ekonomisë, si komision që ka sferë të veprimtarisë përgjegjëse direkt ekonominë, nëse struktura, propozimet e Kuvendit për anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik kalojnë në Komisionin e Ligjeve. Gjithsesi, nëse Erioni nuk do të kalojë te komisioni ynë, ne nuk kemi ndonjë merak të madh, se komision për dhënie mendimi jemi.

Erion Braçe – Mua nuk më intereson fare merak i kurrkujt. Mua më intereson zbatimi i ligjit. Në qoftë se ligji për prokurimin publik ka ngarkuar Komisionin për Ekonominë dhe Financat për këtë gjë, këtë punë duhet ta bëjë ky komision dhe kaq.

Ulsi Manja – Unë nuk dua të bëj debat për këtë çështje, sepse...

Gramoz Ruçi – Mos bëni debat tani. Njëri kërkon të kalojë, tjetri të mos kalojë. E mora vesh.

Ulsi Manja – Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë Komisionit të Ligjeve i ka dhënë Nënkomisionin për Administratën Publike.

Erion Braçe – Shumë mirë, ndryshoni ligjin për prokurimin publik dhe bëjeni Rregullore të Kuvendit, pastaj vazhdoni, bëjeni ju, se unë s’merrem me këtë punë.

Gramoz Ruçi – Zoti Balla.

Taulant Balla – Në fakt, ky është një diskutim që e kemi bërë edhe herën e kaluar, por e rëndësishme është që komision përgjegjës është Komisioni i Ekonomisë, por e zgjidhim, nëse Erioni mendon se nuk ka nevojë, dakord.

Gramoz Ruçi – A ka tjetër?

Lidhur me kërkesën e zotit Vasili, i cili ankohet në shkresën, që i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit, pse nuk është komision përgjegjës Komisioni i Çështjeve Sociale, por Komisioni i Ligjeve, sepse ligji ka të bëjë çështjen e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Një shpjegim për këtë, ju lutem!

Mimoza Pano – Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për disa masa ndaj dhunës në familje”” është depozituar në datën 11 maj dhe tashmë është bërë pjesë e këtij projektkalendari të ri. Konferenca e Kryetarëve e datës 14 maj ka miratuar përfshirjen në projektprogram të këtij projektligji me këtë fushë përgjegjësie të komisioneve: komision

përgjegjës është caktuar Komisioni i Ligjeve dhe komision për dhënie mendimi Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale. Kjo gjë u miratua tri javë më parë në seancë plenare me vendimin nr. 69 të Kuvendit, datë 17 maj 2018.

Nëse do të shikojmë përmbajtjen e projektligjit, dhe kjo ka qenë arsyeja kryesore pse është futur kështu në program që atëherë, nga 19 nene të propozuara, 12 nene janë në fushën e Komisionit të Ligjeve, sepse kanë të bëjnë me çështje të drejtave të njeriut, diskriminimit, Kodit Civil, me çështje të birësimit, të kujdestarisë, me vendimmarrjen e gjykatës, me masat konkrete për urdhrin paraprak të mbrojtjes, që janë të gjitha me gjykatën dhe me qeverisjen vendore. Pra, të gjitha këto nene janë në fushën e përgjegjësisë të Komisionit të Ligjeve.

Po të shikojmë eksperiencën e mëparshme, ky projektligj, fillimisht, ka qenë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve, pastaj ka kaluar, sipas tematikës së ndryshimeve, te Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale.

Shembulli konkret që ka ndodhur së fundi është rasti i projektligjit “Për strehimin social”, ku, edhe pse strehimin e mbulon si fushë Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, meqenëse dominonin çështjet sociale, u vlerësua që të ishte në përgjegjësinë e Komisionit të Punës dhe Çështjeve Sociale. Kjo ka qenë arsyeja.

Ermonela Felaj – Unë e bëra kërkesën, që Komisioni i Sigurisë të ketë mundësi të japë mendim për këtë ligj edhe për një arsye shumë të rëndësishme, kështu që gjykoj se nuk mund të jemi shumë të ngurtë, në kuptimin që dispozitat e propozuara kanë këtë përmbajtje dhe ato i shkojnë këtij komisioni. Ku e kam fjalën?! Ligji në fjalë është një ligj që ka 12 vjet në veprim, të cilin nuk e ka propozuar qeveria, nuk e ka propozuar asnjë nga deputetët, por është nismë qytetare dhe, normalisht, pas 12 vjetësh, kur i vetmi veprim që ka bërë ish-qeveria ka qenë nxjerrja e një akti nënligjor, i cili nuk ka pasur asnjë lloj vlere edhe për faktin se, sa herë ka pasur ngjarje kur gra kanë humbur jetën, në Shqipëri është ndezur një debat i madh publik, unë gjykoj se ne duhet t’u kushtojmë vëmendje ndryshimeve që janë propozuar, sepse mund të jetë rasti që, krahas atyre ndryshimeve, deputetët të propozojnë edhe ndryshime të tjera, që ndoshta shkojnë përtej propozimeve me natyrë civile, por kanë më tepër natyrë sanksionuese dhe ndëshkuese, për të mundësuar një luftë që kemi premtuar se do ta bëjmë. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar një rezolutë për masat dhe hapat që duhet ndërmarrë për të luftuar këtë fenomen. Kështu që besoj se nuk ka asgjë të keqe që komisioni ynë të përfshihet për dhënie mendimi në këtë projektligj. Përkundrazi, do të ishte një kontribut i shtuar në këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ashtu, ka një rezolutë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për çështjen e sigurisë së grave, rezolutë që ne disa herë na është kërkuar edhe në komisionin tonë ta trajtojmë,

por për shkak se Rregullorja imponon një rregull të ngurtë, që ne të merremi vetëm me çështjet e policisë, ushtrisë dhe shërbimeve inteligjente...

Gramoz Ruçi – Pra, ju kërkoni që të kalojë edhe te komisioni juaj?

Ermonela Felaj – Ne kërkojmë që të kalojë edhe te komisioni ynë për dhënie mendimi.

Gramoz Ruçi – Patjetër.

Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë u njoha me kërkesën që ka bërë zoti Vasili dhe pajtohem edhe me diskutimin që bëri zonja Felaj. Ky është një ligj, i cili është miratuar si nismë e shoqërisë civile, është e vërtetë, është vlerësuar në kuadër të mekanizmit të GRECO-s. Shqipëria në dhjetor të vitit 2017 ka marrë një raport, ku i ka kërkuar me urgjencë Kuvendit të shqyrtojë përmirësime të këtij projektligji, me qëllim që gratë të mbrohen më mirë.

Unë jam njohur edhe me projektligjin, por, njëkohësisht, në Kuvendin e Shqipërisë, jo vetëm në adresën time, por edhe në adresë të disa kolegëve të Komisionit të Ligjeve, kanë ardhur shtesa për amendamente të tjera, të cilat duhen vlerësuar. Komisioni i Ligjeve duhet të jetë komision përgjegjës, pasi disa nga rregullimet kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë. Të gjitha gratë deputete kanë qenë pjesë e diskutimit publik të projektligjit. Ligji ka pasur probleme të karakterit kushtetues, ndaj dhe ne u kërkuam ministres së Drejtësisë dhe ministres së Shëndetësisë ta ripunonin dhe ta shikonin ligjin para se të vinte në Kuvend.

Së dyti, ky ligj ka lidhje të forta me disa kode, por ka lidhje të forta edhe me punën që duhet të bëjnë shërbimi i provës, Policia e Shtetit dhe, me të drejtë, këtu pajtohem me kërkesën që bën edhe zonja Felaj për të kaluar edhe në Komisionin e Sigurisë.

Nga ana tjetër, meqenëse këtu është pjesa më e madhe e drejtuesve të komisioneve, kërkoj që Kuvendi t'i japë vëmendjen e duhur, pasi është një nga problemet që na ka dalë nga rekomandimet që ka bërë GRECO, pra mekanizmi i Këshillit të Europës, faktit që ky ligj nuk ka buxhetimin e duhur dhe ka probleme në zbatimin e tij.

Meqenëse këtu kemi kolegun Braçe, i cili drejton Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave, do të ishte shumë mirë që të ishim të vëmendshëm që t'i jepnim kohë konsultimit publik edhe në komisionet tona, por të jemi më të vëmendshëm për mbulimin financiar të këtij ligji.

Së fundi, i kemi kërkuar Këshillit të Ministrave të iniciojë shumë shpejt hartimin e një ligji për parandalimin e dhunës në tërësi, pra jo vetëm të dhunës në familje, pasi zoti Kryetar, unë dhe disa kolegë të tjerë kemi marrë nismën për të parandaluar dhe për të dënuar dhunën seksuale, dhunën në vendin e punës e të tjerë. Ky ligj nuk i adreson sa dhe si duhet, dhe vërtet

Kuvendi është në pozitën që nuk përmbush ato që ka miratuar në rezolutën e fundit lidhur me parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Kështu mund t'i jepet një përgjigje edhe kolegut Vasili për të gjithë problematikën që ka ligji dhe për nevojën për ta parë në raport me Kushtetutën, me kodet dhe me ligjet e tjera që janë në fuqi, por edhe me reformën në drejtësi, pra me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi, të cilat kanë peshë dhe duhen parë me kujdes.

Faleminderit!

Erion Braçe – Natyrisht, unë e kuptoj procesin ligjvënës, zonja Nënkryetare, pa asnjë lloj diskutimi i kuptoj edhe nevojat për të financuar, por dua që gjithkush që merret me këto ligje, që vijnë edhe si propozime të qytetarëve, duhet të kuptojë se buxheti është miratuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë edhe për nismat e qytetarëve, zonja Vasilika, duhet të kuptojnë se buxheti është miratuar vjet. Buxheti nuk mund të cenohet gjatë vitit, me çfarëdo akti që do të nxjerrim ne nga parlamenti. Në qoftë se buxheti do të cenohet gjatë vitit, pa asnjë lloj diskutimi, propozuesi duhet të tregojë edhe burimet e financimit. Në rast se nuk i tregon këto burime financimi, cenon parimet bazë, që i kemi miratuar me ligjin e buxhetit, veçanërisht deficitin financiar, dhe për shkak të tij edhe borxhin publik, që janë detyrime themelore, që ne i marrim kur miratojmë ligjin e buxhetit të shtetit.

Kështu që të gjithë të bëjnë kujdes se, qoftë edhe një amendim i vetëm, që bëhet me një ligj respektiv në Kuvend, krijon impakt të drejtpërdrejtë te buxhetin e shtetit. Pa asnjë lloj diskutimi do të rezultojë ajo që thatë ju, që mund t'ju bëjnë vërejtje se ky ligj nuk është i buxhetuar, sepse paraqitet apo miratohet në maj dhe buxheti është miratuar një vit më parë. Kështu që duhet të presë fundin e vitit për t'u buxhetuar. Kjo është gjëja më normale kur ndodh kjo gjë.

Gramoz Ruçi – Po, urdhëroni!

Ulsi Manja – Unë kam diçka lidhur me kërkesën e zotit Vasili, i cili kërkon që për projektligjin “Për masat e dhunës në familje”, komision përgjegjës të jetë Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe jo Komisioni i Ligjeve, apo anasjelltas. Në fakt, ky pretendim nuk më duket logjik, për faktin se çështjet e dhunës në familje lidhen drejtpërdrejt me respektimin të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nëse për këtë projektligj nuk do të jemi ne komisioni përgjegjës, atëherë nuk ka asnjë kuptim që ky komision të ketë Nënkomisionin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Kështu që është shumë mirë që Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë është komision për dhënie mendimi, por komision përgjegjës, në vazhden e

diskutimit të koleges Hysi, duhet të mbetet siç është miratuar në program dhe është propozuar në projektkalendar.

Gramoz Ruçi – A ka dikush tjetër ndonjë gjë?

Ermonela Felaj - Vijnë të jetë në kalendar iniciativa për ndryshimin e Kodit Penal, e propozuar nga kolegu Tahiri, por kuptohet që nuk mund të vazhdojë më për sa kohë kolegu Tahiri ka lënë mandatin.

Unë gjykoj se një prej atyre nismave (nuk dua ta shndërrojmë këtë mbledhje në një mbledhje qesharake, sepse kështu duket kur përmend këto lloj temash, por realisht është bërë problem dhe ne duhet t'i përgjigjemi) besoj se ka të bëjë me propozimin për mënyrën e mbajtjes së qenve, pasi edhe në ditët e fundit ka pasur shumë shqetësime për shkak se janë sulmuar njerëz dhe fëmijë. Unë besoj se iniciativën që ka paraqitur Saimiri mund ta rimarrë dikush nga ne dhe ta kalojmë, se nuk ka arsye që ta mbajmë në kalendar javë pas jave.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po them që duhet ta marrë dikush nga ne në një kohë të dytë, jo menjëherë. Pra, ideja është që ta adoptojmë tekstin, sepse është i gatshëm.

Në mënyrë që të mos e marr dy herë fjalën, dhe ju kërkoj ndjesë për këtë, dua të them se ju keni pasur një takim me një grup të deputetëve kosovarë, përfshirë edhe nënkryetaren e Kuvendit të Kosovës, ku na është kërkuar një veprim nga ana e Kuvendit të Shqipërisë lidhur me miratimin e tri rezolutave që ka bërë Kuvendi i Kosovës. Nuk e di nëse është rasti që ta bisedojmë, por a mundemi ne si Kuvend që të përcaktojmë një planveprimi, që t'i përgjigjemi në mënyrë uniforme Kuvendit të Kosovës në lidhje me propozimet që ata na kanë bërë gjatë ditës së sotme?

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Zoti Kryetar, unë kam një çështje jashtë rendit të ditës.

Shpesh kolegët deputetë, por edhe drejtuesit e komisioneve nuk kanë informacionin e mjaftueshëm të rezolutave, si dhe të vendimeve të miratuara në Kuvend, jo në këtë legjislaturë, por në legjislaturat e kaluara.

E mira do të ishte që ne në mbledhjen e Konferencës së Kryeartëve t'i informonim ata lidhur me tri mekanizmat që Kuvendi i Shqipërisë ka ngritur: Mekanizmin e Monitorimit të Rekomandimeve të Institucioneve Kushtetuese të Pavarura të Krijuara me Ligj, si dhe detyrimet që ka çdo komision sipas vendimit të botuar në Fletoren Zyrtare.

Së dyti, ne kemi një detyrim, që në fund të vitit do të ketë një raportim për të gjithë veprimtarinë e Kuvendit lidhur me përmbushjen e vendimit që ka marrë Kuvendi më parë dhe konkretisht të çdo veprimtarie që bën komisioni lidhur me rekomandimet e 22 institucioneve

që raportojnë Kuvendin e Shqipërisë. Do të ishte mirë të kishim një analizë 6-mujore para se të shkohet në raportimin që ju, si kryetar i mekanizmit, duhet të bëni në muajin dhjetor, përsëri në bazë të këtij vendimi, i cili është vendim zyrtar dhe është i botuar në Fletoren Zyrtare. Pra, meqenëse kemi zëvendëskryeministren këtu, do të ishte mirë që edhe qeveria të na bënte një raport për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ky mekanizëm, pasi aty ka një raportim që duhet ta bëjë Kryetari i Këshillit të Ministrave, Kryeministri i vendit, nuk di se sa i është vënë në vëmendje një gjë e tillë.

E dyta, për zbatimin e të gjitha rekomandimeve që u janë adresuar institucioneve dhe problematikat që mund të kenë hasur ministrinë për zbatimin e tyre, kjo është thjesht për kujtesë, sepse parlamenti nuk punon në gusht dhe nuk do të kemi kohë që për 2 muaj të rikuperojmë gjithë atë punë që duhet bërë që nga 1 janari.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - A ka ndonjë tjetër që e do fjalën?

Në mbyllje, lidhur me kalendarin, duke qenë se opozita nuk është prezente në këtë takim të Konferencës së Kryetarëve, do të shtoja që ne në asnjë mënyrë nuk duhet që të drejtën e diskutimit në komisione, edhe sipas kërkesës së drejtuesve të komisioneve, ta kufizojmë dhe është normale që secili komision të japë kontributet e veta. E para.

E dyta, të jemi më komplementarë nga komisioni në komision, pavarësisht se si rregull është përcaktuar që një komision është përgjegjës, sigurisht është seanca plenare që ka detyrimin në të gjitha rastet që mendimet të unifikohen edhe kur ato unifikohen nga komisioni përgjegjës deri te komisioni që jep mendimin. Është e drejta e seancës që edhe deputetët individualisht, edhe komisionet paralelisht me to, kur kanë një mendim ndryshe, të bëhen objekt i diskutimit, i gjyqimit dhe i vlerësimit dhe më pas votimi bëhet në seancë plenare.

Për sa i përket çështjes së rezolutave të kolegëve tanë në Kosovë, sigurisht që unë i takova ata dhe besoj se janë takuar edhe me drejtuesit e komisioneve. A janë takuar me zotin Shalsi?

(Diskutime pa mikrofon)

Ne kemi gjithë vullnetin për ta mbështetur këtë çështje, por unë do të nënvizoja se nuk më duket shumë oportune që rezolutë parlamenti i Kosovës, rezolutë parlamenti shqiptar. Ajo që ne duhet të bëjmë është kjo, sa do të jemi në gjendje për të implementuar dhe iniciuar marrëveshje të këtij lloji, që ato të jenë të implementueshme nga ana e ekzekutivit. Janë bërë shumë marrëveshje midis dy qeverive tona në mbledhjet e përbashkëta, por ato nuk janë implementuar sa duhet, kështu që, duke pasur edhe zëvendëskryeministren të pranishme, do të kërkoja mirëkuptimin që ato marrëveshje, tashmë të miratuara nga qeveritë respektive, në qoftë

se ka probleme që nuk janë ratifikuar në parlamentin e Kosovës apo të Shqipërisë, të ratifikohen, të zbatohen, siç është problemi në fushën e arsimit apo në fusha në tjera, ose edhe për lëvizjen e lirë të mallrave dhe të njerëzve. Unë e di se ka një marrëveshje midis dy qeverive, ku fillimisht ka qenë pengesë pala kosovare, por këtu nuk dua të nxjerr se kush e ka përgjegjësinë, pala kosovare apo shqiptare. Çështja qëndron se, në qoftë se ka një marrëveshje, duhet shpejtuar ta ratifikojmë; në qoftë se ka një marrëveshje dhe nuk zbatohet, atëherë komisionet respektive mund të thërrasin ministrin apo ministren përkatëse në komisione ose në seancat e parlamentit me qëllim që të mos ngelen të tilla, ashtu sikurse në rastin konkret për çështjen e *rooming*-ut. Sigurisht, duke shpalosur këtë vullnet të mirë që kanë rezolutat e miratuara nga kolegët kosovarë, është misioni ynë t'i ndjekim ato.

Për sa i përket monitorimit të organeve kushtetuese problematike, që me të drejtë e ngriti nënkryetaria e Kuvendit, zonja Hysi, është një problem që duhet të jetë në vëmendjen e të gjitha komisioneve sipas mbulimit të fushës përkatëse dhe pastaj i mekanizmit parlamentar. Praktika e mirë ka qenë që është dëgjuar në komision, është hartuar rezoluta dhe është raportuar në Kuvend. E rëndësishme është të mos ngelen pa u ndjekur të gjitha rekomandimet e bëra apo konkluzionet që kanë arritur rezolutat përkatëse.

Fjala për zotin Shalsi.

Eduard Shalsi – Faleminderit, Kryetar!

Që prej muajit nëntor, nuk e di e ka kërkuar Erioni apo Taulanti, po presim nga qeveria një informacion lidhur me statusin e të gjitha marrëveshjeve të firmosura midis dy qeverive, të cilat ende nuk i kemi. Nuk e di pse! Në radhë të parë, duam një informacion për ecurinë e marrëveshjeve.

Së dyti, në vizitën time zyrtare me Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit në Kosovë në vitin 2015, një nga çështjet e diskutuara ishte çështja e *rooming*-ut. Në atë kohë na u dhanë të gjitha argumentet si nga AKEP-i shqiptar, ashtu edhe nga institucioni homolog kosovar dhe, mbas diskutimeve me specialistët, ne nuk mund ta ndërmerrim një iniciativë të tillë për shkak se kishim aplikuar dhe donim të bëheshim pjesë e një marrëveshjeje të firmosur nga katër vende, respektivisht nga Bosnjë Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia. Pra, për sa kohë që do të donim të bëheshim pjesë e një marrëveshjeje, nuk mund të firmosim marrëveshjet bilaterale.

Homologët kosovarë sot më thanë që nuk është e vërtetë, mund të firmosim një marrëveshje bilaterale dhe çdo argument që kemi pasur të paktën për këta 2-3 vjet, sipas tyre, nuk qëndron. Ndaj, mora edhe rastin e *rooming*-ut, meqenëse e kemi diskutuar hapur vite më

parë, është një moment që përpara se të flasim me pasion apo të shprehim vullnetin, ne të gjithë duam ta bëjmë atë punë, duhet të shikojmë kontekstin.

Në Samitin e Sofjes, në dijeninë time, Shqipëria ka marrë një angazhim së bashku me Kosovën dhe të dyja vendet kanë aplikuar për t'iu bashkëngjitur marrëveshjes katërpalëshe. Si është, ku jemi dhe në çfarë faze ndodhemi, të gjitha këto informacione ia dhashë edhe delegacionit kosovar. Një pjesë e deputetëve që takova në Prishtinë gjatë mbledhjes së përbashkët të komisioneve respektive kanë ndryshuar, ndaj duhet të jemi të kujdesshëm për gjërat që marrim përsipër, dhe nga ana tjetër të mos dominojë dëshira dhe vullneti para arsyes.

Do të ishte e vlefshme, e përsëris, që mbledhjet e qeverisë që janë konkluduar midis dy vendeve me firmosjen e një grupi marrëveshjesh, të dinim ku janë. Gjithashtu, edhe për çështje të tilla të rëndësishme si çështja e *rooming*-ut, të mos bëjmë hapa të nxituar, por të gjykojmë me maturi të gjitha efektet e iniciativave të tilla.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Lidhur me këtë çështje, duhet të kemi parasysh dy gjëra: është gjë shumë e mirë që edhe vendet e Bashkimit Europian e kanë hequr *rooming*-un me njëri-tjetrin. Ka një nismë për Ballkanin Perëndimor, që e njëjta gjë të bëhet edhe për rajonin.

Shalsi ka të drejtë kur pyet – “ku jemi ne, deri ku po shkon?”. Në informacionin tim modest, nuk e di sa e vërtetë është, Serbia është kundër përfshirjes së Kosovës në këtë marrëveshje rajonale. Del problemi, a do të bëhemi ne pjesë e një marrëveshjeje rajonale kur të pranojmë dhe të nënshkruajmë që Kosova përjashtohet sipas kërkesës së palës serbe? Domethënë, ky është një problem që duhet parë qoftë nga pikëpamja diplomatike, qoftë nga pikëpamja ekonomike, qoftë nga ajo e marrëveshjeve ndërshtetërore etj.

Sigurisht, që këto edhe e predispozojnë njëra-tjetrën, edhe e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Në kushtet që nëse do të biesh dakord, që në kuadrin e një marrëveshjeje rajonale të përfshihej edhe Kosova, do të ishte në të mirë të Kosovës dhe në të mirë të rajonit, sepse kjo do të ishte një njohje indirekte nga ana e Serbisë, e cila do të nënshkruante dhe do ta bënte pjesë të nënshkrimit Kosovën. Kjo do të ishte në të mirë të Kosovës.

Nëse jo, atëherë detyrimisht del si detyrim i qeverisë shqiptare dhe i qeverisë së Kosovës që ta shohin këtë çështje në marrëdhëniet bilaterale pa penguar njëra-tjetrën, si marrëveshja rajonale, sepse sigurisht edhe ne nuk mund ta përjashtojnë veten nga kjo marrëveshje rajonale. Po ashtu, nuk mund ta përjashtojmë veten nga një marrëveshje bilaterale me Kosovën.

Urdhëroni!

Senida Mesi – Është e vërtetë që Shqipëria dhe Kosova ishin dy vendet e fundit të Ballkanit Perëndimor, që nuk ishin pjesë e kësaj marrëveshjeje mes shteteve të Ballkanit Perëndimor në lidhje me tarifën e reduktuar *roaming* (nuk bëhet fjalë për tarifa falas). Në Samitin Dixhital të Sofjes edhe në praninë e komisioneres së BE-së, Gabriel, ne shkuam së bashku me përfaqësuesit e Kosovës me një kërkesë zyrtare nga dy ministrat respektivë për Infrastrukturën, në lidhje me pjesët e telefonisë, sigurisht, edhe në praninë e komisioneres së BE-së, Kërkesa u bë zyrtare dhe u mirëprit si e tillë. Më pas mbetet ratifikimi i marrëveshjes ku do të konkludohet dhe do të firmoset nga 4 shtetet aktuale së bashku me dy shtetet e reja, që do të jenë pjesë e një marrëveshjeje të tillë.

Ndërkohë, për dy pikat e tjera për kontrollin doganor, liberalizimin e kontrollit doganor dhe për pikën e përbashkët doganorë, janë firmosur kontratat dhe marrëveshjet. Është e vërtetë që firmosen kontratat, sepse kjo është bërë rutinë tashmë, edhe në marrëveshjen me Maqedoninë, edhe me Kosovën (së shpejti do të kemi edhe mbledhjen me Malin e Zi), ku marrim përsipër që të gjitha kontratat për të cilat ne biem dakord jo thjesht t'i raportojmë, por edhe t'i ndjekim në bazë të një rutine, pasi ndodh në takimet e ardhshme të këtyre mbledhjeve, shumë nga këto dakordësime që kemi bërë, të mbeten thjesht në letër dhe pa veprime konkrete.

Sfida jonë është të jemi pjesë e Ballkanit Perëndimor në këtë marrëveshje. Nuk e di nëse kjo kontratë ka ndikuar ndonjë nen, i cili e përjashton mundësinë e bërjes së marrëveshjeve bilaterale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më jepni kohë ta kontrolloj dhe do t'ju vijë me një përgjigje zyrtare.

Gramoz Ruçi – Si pikë orientimi do të mbetet kjo, sepse bëri kërkesë zonja Felaj që të bëjmë edhe ne një rezolutë. Për mendimin tim, kjo nuk zgjidhet me rezoluta, zonja Felaj. Kjo zgjidhet nëpërmjet dy qeverive respektive.

E theksoj edhe një herë: nëse ne arrijmë të përshpejtojmë marrëveshjen rajonale, ku përfshihet edhe Kosova, kjo do të ishte në të mirë të rajonit dhe në të mirë të Kosovës, madje 2 herë në të mirë të Kosovës, sepse është një njohje *de facto* edhe nga pala serbe, që Kosova të bëhet pjesë e nënshkrimit në një marrëveshje bashkë me Serbinë.

Nëse jo, atëherë duhet gjetur zgjidhja Shqipëri-Kosovë, të cilat duhet të ulen bashkë. Unë besoj se nuk ka shqiptar në Kosovë dhe nuk ka shqiptar në Shqipëri që të jetë kundër një marrëveshjeje të tillë.

Çështja është që të rakordojmë dhe të shikojmë se ku jemi për këtë çështje, që të mos dalë sikur pala shqiptare nuk është shumë e fokusuar në këtë çështje. Përkundrazi, jemi shumë

të interesuar që Kosova të ketë një njohje ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare siç është kjo marrëveshje rajonale. Në qoftë se arrihet kjo e para, është më mirë.

Nëse nuk realizohet kjo e para, atëherë duhet të ecim me marrëveshje bilaterale midis dy vendeve tona.

Mirë, e mbyllim mbledhjen!

Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET